


POEZI TË FERNANDO PESSOA's



Përkthyer nga Moikom Zeqo

FJALË FLUTURAKE HYRËSE

Në qershor të vitit 1998 isha në Lisbonë të Portugalisë. Kisha ideuar dhe konceptuar pavijonin "Albania" në Ekspozitën botërore në Lisbonë. Por Lisbona kishte një emër të dytë: Fernando Pessoa. Në manastirin e shën Hieronimit, ku ishin varret e mbretërve të Portugalisë që ngritur në 1985 një shtyllë katërkëndëshe memoriale për Pessoa. Më e thjeshta në botë. Më kujtoi sekuencën e filmit të Kumbrikut, ku një tufë

majmunësh, ende të paevoluar në njerëz, shohin befas një shtyllë metalike të sofistikuara, si të ardhur nga planetë të tjerë. Kjo ndjesi që torturouese, gati fatale.

E përqafova shtyllën e thjeshtë të Pessoa - nuk që një shtyllë dorike, apo si e tempujve egjiptianë.

Në një faqe të shtyllës qenë gdhendur vargjet:

Nao Basta abrir a janele

Para ver os campos e o rio.

Nao e bastante nao ser cego

Para ver as arvores e flores.

Alberto Caeiro

(Nuk mjafton të hapësh dritaren

Për të parë fushat dhe lumin.

Nuk mjafton të jesh i verbër

Për të parë pemët dhe lulet.

Albert Kajero)

Në faqen tjetër këto vargje gjithashtu të çuditshme:

Nao quero nada.

Ja disse que nao quero nada

Nao me verham com conclusoes!

A unica conclusao e morres!

Alvaro de Campos

(Nuk dua asgjë.

Ju thashë se nuk dua asgjë.

Mos më vini me përfundime!

Përfundimi i vetëm është të vdesësh!

Alvar de Kampos)

Alberto Caeiro dhe Alvaro de Campos janë pseudonimet e tij. Ai ka përdorur 40 të tilla - e fragmentarizon vetveten duke e plotësuar. Pessoa'a është një mrekulli dhe çudi e shekujve. Ende i pazbuluar tërësisht. Kam shkruar disa herë për krijimtarinë e Pessoa'as, kam bërë edhe skica dhe portrete me ngjyra të tij. Poezitë e Pessoa's i kam përkthyer nga librat: "Fernando Pessoa - A Little Larger Than the Entire Universe - selected poems -

edited and translated by Richard Zenith", USA, 1998 dhe
Fernando Pessoa - "L'Enigma e le maschere", traduzione di
Pietro Civitareale, Arnoldo Mondadori Editore, 1993.

MOIKOM ZEKO
Tiranë, fundshkurt 2014

۲ ۲ ۲ ۲ ۲ ۲

POEZI TË FERNANDO PESSOA'S



Përkthyer nga Moikom Zeqo

~~~~~

### **EPITAF**

*Nuk jam asgjë  
E nuk do të jem kurrë asgjë,  
Nuk dua të jem një hiç,  
Megjithatë kam brenda vetes tërë ëndërrat e botës!*

\* \* \*

### **LAPIDARI VOTIV**

*Ç'mundim i madh,  
E sa i vogël njeriu!  
Unë Diego Lundërtari kam ngulur  
Këtë lapidar në arenën e errët  
E kam lundruar drejt detit të amshuar!*

*Hyjnor është shpirti,  
Vepra njerëzore e papërsosur!  
Ky lapidar i rrëfen erës dhe qiejve të verbër  
Se prej veprës së arritur  
E imja është pjesa e përmbushur  
Ç'ka mbetet i përket Zotit!  
Dhe oqeanit si mundësi pa kufij  
Lapidari në heshtje i thotë  
Se deti i njohur do të jetë grek ose romak,  
Portugez do të jetë deti i pafund!  
Kryqi i latuar  
Thotë ç'kam në shpirt  
Duke përndritur  
Brenda meje ethet e lundrimit,  
Të gjej në qetësinë e përjetshme të Zotit  
Pikërisht partin që më në fund duhet gjetur!*

*\* \* \**

## **POEZIA**

*Në mendje më përgjumet poezia  
Që shpreh tërë shpirtin tim  
Është e vagullt e papërcaktuar si ere  
E megjithatë e skalitur kaq saktë!  
S'ka strofa, vargje, as fjalë  
Madje s'është ashtu siç e ëndërroj  
Po vetëm ndjesi e pastër pa përmasa,  
Rreth mendimit një brymë lumturie!  
Ditë e net në misterin tim e ndjej  
E lexoj, më kot përpiqem ta rrokjezoj  
Fjala e qartë rri në vehten time  
Njëkohësisht pezull në plotësinë e mjegullt.  
E di se nuk do të shkruhet kurrë  
E di se nuk e kam idenë se ç'është  
Po ndihem i kënaqur  
Që veç e ëndërroj !*

\*\*\*

*Përherë diçka mungon  
Një gotë, një fllad, një frazë  
Jeta dhemb më shumë kur shijohet  
E akoma më shumë kur trillohet*

\* \* \*

### **ULIKSI**

*Ç'është miti? Asgjëja që është gjithçka!  
Është i njëjti Diell që përhapet qiejve –  
Mit drite i heshtur –  
Trup i gjallë i Zotit,  
Por edhe i vdekur dhe lakuriq!  
Uliksi që përherë bujti  
Njësoj si të mos qe i pranishëm  
Edhe pa ekzistencë qe krejt i mjaftueshëm  
Erdhi për të mos qenë i ardhur  
E na krijoi!  
Kështu miti ndërfitet  
Në realitet, duke e pllenuar,  
Pastaj gjithçka rrjedh  
Në uljen e jetës  
Pjesa e asgjësë vdes!*

\* \* \*

### **ISHUJT ME FAT**

*Ç'zë vjen mbi zhurmat e dallgëve  
E s'është zëri i detit?  
Mos është zëri i dikujt që ndal  
Në çastin kur duam ta dëgjojmë?  
Nëse gjysmë të përgjumur  
E ndjejmë pa e ditur se e ndjejmë  
Ky zë flet për shpresën  
E lëvizim drejt tij si qenia në gjumë.  
Janë ishuj të bekuar  
Toka pa cak, ku Mbreti i tyre jeton,*

*Po nëse arrijmë më në fund aty  
Zëri humbet e mbetet vetëm deti!*

*\*\*\**

*Gjithë natën s'munda të fle dot  
Nga horizonti i errët dhe i ftohtë vjen mëngjesi.  
Pse ekzistoj në këtë botë?  
Për asgjë që nata qetëson,  
Për asgjë që ngjall dita e re,  
Për asgjë serioze,  
Për asgjë të kotë?  
Syenjtur nga ethet pa kufij të pritjes  
Me frikë shoh agimin e ditës,  
Që përsërit të njëjtën ditë të fundit  
Të botës dhe të dhimbjes  
Ditë e ngjashme si gjithë të tjerat  
Në familjen e përjetshme  
Të të qenit përherë kështu.  
S'ka vlerë simboli  
I kuptimit të mëngjesit që ngadalë vjen  
Ngritur nga e njëjta esencë e natës së shkuar  
Për njeriun që shumë herë ka pritur diçka  
E tashmë asgjë nuk pret!*

*\*\*\**

*S'jam asgjë, s'mundem për asgjë, s'ndjek askënd,  
Plot iluzione çoj qenien time pas meje  
S'di të hamendësoj, s'di nëse duhet të jem,  
Duke qenë asgjë, ose ajo gjë që s'do të jem.  
E lë pas çdo gjë që është asgjë –  
Një erë bosh të Jugut, poshtë të pafundmit qiell,  
Që më bie sipër e unë befasisht rrëqethem  
Mes gjelbërimit që s'është unë.  
Të kesh të drejtë për të fituar dashuri  
E të kalbesh si trangu i vdekur i iluzionit,  
Të ëndërrosh, është asgjë, të mos dish është boshllëk,*

*O zemër e pasigurtë fli në hije!*

\*\*\*

*Mes degësh të larta pemësh plot gjethe*

*Lëviz e ftohta zhurmë e erës*

*Në pyll e në tinguj humbas,*

*Meditoj në vetmi!*

*Në botë, përmbi atë që ndjej*

*Era bën jetën e saj, e lëshon dhe e merr prapë*

*Dhe asgjë s'ka kuptim, madje as shpirti*

*Me të cilin mendoj krejt i vetëm!*

\*\*\*

*Në kujtoj kush isha i ndryshëm shihem*

*E kaluara është e tashmja e kujtesës*

*Ç'kam qenë është dikush që e dua*

*Por veç nëpër ëndërra.*

*Malli që ma plagos mendjen*

*S'është imi as edhe i së kaluarës së parë*

*Por vetëm i çastit që jetoj*

*Brenda syve të verbër.*

*Asgjë, përveç këtij çasti, s'më njeh,*

*Asgjë s'është kujtimi im i njëjtë.*

*Të ndjej se cili jam e cili kam qenë*

*Janë ëndërra të ndryshme !*

\*\*\*

*Në botë, vetëm me vehten, lemë*

*Zotat që të vendosin*

*S'bëjmë dot kundër tyre*

*Pranojmë pa kundërshtim ç'na japin.*

*Gruri përkulet nga era*

*Po kur era pushon, ngrihet përsëri!*

\*\*\*

*Jo vetëm kush na urren ose na ka zili*

*Na pengon e na shtyp,*

*Kush na do*

*Jo më pak na kufizon!  
Zotat më lejofshin, larg nga dashuritë  
Të kem lirinë e ftohtë të rri lakuriq  
Kush do pak ka gjithçka  
Kush nuk ka e nuk dëshiron  
Është njeri i ngjashëm me zotat!*

\*\*\*

*Disa, sykthyer tek e shkuara  
Shohin atë që s'e shohin dot  
Të tjerët tek e ardhmja shohin  
Gjithçka që s'mund të shihet.  
Pse kërkojmë aq larg  
Atë që na është afër?  
Kjo është dita, është ora, është momenti  
Kjo është ajo që jemi e s'është gjë tjetër!*

\* \* \*

### **POEZI TË RIKARD REISIT**

\*\*\*

*Para nesh mbi të njëjtat pemë  
Kaloj era. Era që erdhi dikur,  
Kur gjethet s'qenë e s'flisnin,  
Ndryshe nga mënyra e sotme.  
Kalojmë i hakërrohemi më kot  
E s'bëjmë më zhurmë në hapësira,  
Aq sa bëjnë gjethet e pemës  
Dhe hapat e erës.  
Përpiqemi pa e kuptuar  
T'i ofrojmë vullnetin tonë natyrës  
E të mos përfitojmë më tepër jetë  
Sa ajo e vetë pemëve.  
Kotësisht ngjajmë të mëdhenj  
Përveç nesh askush tjetër  
Nuk e shpall gjoja madhështinë tonë,  
Që as na shërben nëse e dëshirojmë.*



*E nëse tani këtu në bregdet  
Gjurmën time mbi rërë deti e fshin  
Ç' do të ngjajnë në atë plazhin hyjnor  
Ku deti është vetë koha?*

*\*\*\**

*Ndiq fatin tënd!  
Bimët tuaja ujiti,  
Duaji trëndafilat e tu  
Ç'ka mbetet  
Është hija e bimëve të huaja!  
Realiteti është  
O më shumë o më pak  
Prej atij që dëshirojmë  
Vetëm ne jemi gjithnjë  
Të barabartë me vehten.  
E ëmbël është të jetosh vetëm.  
Madhërishtëm dhe hijshëm është  
Të jetosh përherë me thjeshtësi  
Lere dhimbjen në territoret e saj  
Si dhuratë prej zotave!  
Kthjelltësisht imito  
Veç Olimpin  
Në fshehtësinë e zemrës tënde  
Zotat janë zota  
Sepse nuk mendohen!*

*\*\*\**

*Jo për mua por për ty  
Janë këto kurora trandafilash  
Bëji kurorat për ballin tënd  
Kurorat e mia s'i shoh asgjëkundi.  
Njeri pas tjetrit o djalë ne bëjmë  
Një bukuri shterpe por të mjaftueshme  
Për një përdëllim sëbashku  
Me kënaqësinë e shfaqur tek sytë.*

*Çdo gjë tjetër i përket Fatit  
Që na mat jetën  
Me rrahjen e gjakut në tëmthat,  
Gjersa ende s'ka arritur varkëtari Karont.  
\*\*\**

*S'mjafton të hapësh dritaren  
Për të parë fshatin dhe lumin  
S'mjafton të mos jesh i verbër  
Për të parë pemët dhe lulet.  
E nevojshme është  
Të mos kesh asnjë filozofi  
Me filozofinë ju s'gjeni pemë,  
Por vetëm ide.  
Është vetëm dritarja e mbyllur  
Dhe gjithë bota jashtë  
Dhe një ëndërr e asaj që do të shikohej  
E kurrë s'shihet, nëse dritarja do të hapej.  
\*\*\**

*Nëse mbas vdekjes time  
Duan të ma shkruajnë jetëshkrimin  
S'ka gjë më të thjeshtë  
Kam vetëm dy data  
Të lindjes dhe të vdekjes  
Mes njërës dhe tjetrës  
Tërë ditët janë të miat!  
Kaq e lehtë të më përcaktosh:  
Kam jetuar si një i çmendur  
Kam dashuruar shumë gjëra  
Po pa sentimentalizëm.  
Kurrë s'kam dëshiruar  
Gjëra të pamundshme për t'u realizuar  
Sepse kurrë s'kam qenë i verbër.  
Ndjesimi për mua  
S'qe veç shoqërimi i të parit*

*Kam kuptuar se gjërat janë reale  
E të gjitha të ndryshme.  
E këto i kam kuptuar me sy,  
Kurrë me mendim  
T'i kuptoja me mendim  
Do të kishte qenë sikur të gjitha t'i gjeja njëlloj.  
Dhe kështu një ditë  
Si çfarëdolloj fëmije më morri gjumi  
Mbylla sytë e fjeta.  
Prej asaj kohe  
Kam mbetur  
I vetmi poet i natyrës!*

\*\*\*

*Di fare mirë të bëj hamendje:  
Ka diçka që jep jetë  
Tek çdo gjë që është.  
Tek bima është një nimfë e vogël  
Tek kafsha një tjetër qenie e brendëshme  
Tek njeriu është shpirti që jeton me të  
E tashmë është vetë ai.  
Dhe tek Zotat ka të njëjtat përmasa  
Në çdo hapësirë trupore  
Dhe që është e njëjta gjë e trupit.  
Ndaj thuhet se zotat s'vdesin kurrë  
Ndaj zotat s'kanë trup dhe shpirt,  
Por vetëm trup,  
Ndaj janë të përsosur.  
Trupi është shpirti i tyre  
Dhe ruajnë vetëdijen  
Në të njëjtin mish hyjnor!*

\*\*\*

*Një ditë do të më përvëlonte dëshira:  
Të kisha punuar më shumë,  
Mos ta ndërprisja të shkruarin...*

*Dhe ndjej  
Si të qe një muzikë mes pemësh  
Atë që mbase është Sekreti i Madh  
A Misteri i Madh,  
Për të cilin poetët shtiren se flasin.  
Pashë që s'ka natyrë,  
Natyra s'ekziston,  
Gjenden male, lugina, lule,  
Fusha, barëra,  
Gjenden lumenj dhe gurë,  
Por nuk ka një gjithçka  
Të cilës ato t'i përkasin,  
Se çdo gjë që është  
Një bashkësi reale dhe e vërtetë  
Është në fakt një sëmundje e ideve tona.  
Natyra është shumë pjesë,  
Po një bosht të vetëm  
Kjo është mbase e mistershmja  
Për të cilën flasim.  
Ishte kjo gjë  
Që pa e menduar  
Dhe pa u përmbajtur një çast  
E pranova që qe e vërteta!*

*\*\*\**

*Zgjohej papritur natën,  
Ndjej ritmin e orës  
E s'e ndjej natyrën jashtë dhomës.  
Dhoma ime është e errët  
Aty këtu në parket ka njolla të bardha  
Qetësia jashtë është kaq absolute  
Sikur asgjë s'ekziston më  
Vetëm ora gjallon me ritmin e saj  
E ka një grumbull ingranazhesh  
E sikur mohon tërë ekzistencën e tokës dhe qiellit...*

*E unë përhubem i tëri  
Kur zbuloj se çfarë nënkupton kjo gjë,  
Por përmbahem e bile buzëqesh në errësi.  
E vetmja gjë që ora ime simbolizon dhe nënkupton  
Duke përbuzur natën e pamatë me vogëlsinë e saj  
Është ndjenja kureshtare  
Që megjithatë arrin  
Ta mbushë natën e pamatë me vogëlsinë e saj.*

\*\*\*

*Hyj në dhomë e mbyll dritaren  
Më sjellin qiririn e më thonë “natën e mirë”  
E unë ua kthej “natën e mirë”.  
Sikur jeta ime të kishte qenë gjithmonë kështu  
Ditë me Diell, ose me shira  
Pastaj e tmerrshme sikur të ish fundi i botës  
Vjen mbrëmja e njerëzit kalojnë.  
Para mbylljes së dritares  
Shikimi i fundit miqësor në bimët e heshtura  
Në krejt botën e më pas dritarja mbyllet,  
Ndizet qiriri e të shtrihesh në shtrat  
Pa lexuar asgjë, pa menduar asgjë  
Po s’arrin dot të flesh  
Sepse ende ndjen jetën që rrjedh brenda teje  
Si lumi në shtratin e tij  
Dhe jashtë është një qetësi e madhe  
Si një Zot që fle.*

\*\*\*

*Të shoh sërish o qytet i fëminisë  
I moshës së parë të humbur frikshëm  
O qytet i trishtë e gazmor  
Ja u ktheva për të të ëndërruar...  
A jam unë që u ktheva?  
I njëjti njeri që këtu dikur jetoi?  
Për t’u kthyer po këtu?*

*A s'do të rikthehet e rikthehet papushim?  
A po jam tërësia e "unë-ve"  
Që këtu kanë qenë, apo kemi qenë?  
Tespithe-qenie të një filli të vetëm kujtese  
Tek mua, a të dikujt jashtë meje?*

*\*\*\**

*Ti qeti anonime buzëqesh  
Me flokët e praruar si fildish  
Përse vallë për të qenë e lumtur  
Lipset të mos e dish?*


*\*\*\**

*Natë. Nata është shumë e errët.  
Në një shtëpi të largët  
Vezullon ndriçimi i dritares.  
Ndërsa e shoh unë ndjehem  
Njerëzor nga koka tek këmbët  
Sa kureshtare është jeta e njeriut që banon aty  
Dhe s'dihet cili është.  
A mundet të më grishë mua  
Vetëm prej asaj drite që duket në largësi?  
S'ka dyshim që jeta e tij është reale  
Ka një pamje, gjeste, familje, profesion.  
Por tani më intereson  
Vetë drita e dritares së tij  
Jo pse drita është atje  
Se ai e ka ndezur llambën.  
Për se prezanton për mua  
Realitetin e menjëhershëm  
Se përtej këtij realiteti të menjëhershëm  
S'ka asgjë tjetër.  
E nëse unë ku jam  
Shoh vetëm atë dritare  
Është vetëm drita në marrëdhënie  
Me distancën që na ndan.*

*Unë jam nga pjesa e këtushme  
Në skajin e distancës  
Njeriu dhe familja e tij janë reale  
Nga pjesa e atjeshme e dritares.  
Drita shuhet  
Ç'rëndësi ka  
Që njeriu  
Të vazhdojë të jetojë?*

*\*\*\**

*Jo, mos thuaj asgjë  
Përfytyro atë  
Që thotë goja jote e mbyllur  
Njësoj si të jesh duke e dëgjuar  
Të ndjesh është më mirë  
Se sa të thuash diçka  
Një gjë që s'preket  
Nga frazat e nga ditët.  
Ji më e mirë se ajo që je,  
Mos flit asgjë,  
Dëlirësia e trupit lakuriq  
Dhe e padukshme shihet.*



\* \* \*

## **POEZI TË ALBERTO CAEIRO**

\*\*\*

*Në duhet të kem një mistikë  
Unë pra e kam  
Por vetëm me trup jam mistik,  
Shpirti im është i thjeshtë e s'mendon.  
Mistika ime është të mos di për asgjë  
Por është jetosh e të mos mendosh.  
S'di çfarë është natyra, por e këndoj,  
Jetoj majë një kodre  
Në një shtëpi të zbardhur me gëlqere  
Por vetmitare.  
Kjo është gjithçka  
Që kam përfundimisht!*

\* \* \*

## **KOLOMBËT**

\* \* \*

*Të tjerëve do t'u rastisë të kenë  
Atë që na takon të humbim.*



*Të tjerë do të arrijnë të gjejnë  
Atë që ne, duke e kërkuar  
E gjetëm dhe s'e gjetëm  
Sipas fatit që vendos!  
Veç ajo që atyre s'u takon  
Është magjia, që kalkulon  
Largësinë dhe bën historinë.  
Për këtë lavdia e tyre  
Është kurora e merituar,  
Dhenë nga një dritë e marrë hua!*

*\*\*\**

*Meditoi për liqenin  
Që era e rrengjeth  
S'di nëse mendoj gjithçka  
E gjithçkaja më harron!  
S'më thotë gjë liqeni  
As flladi i padukshëm  
S'di nëse jam i lumtur  
S'e s'dëshiroj të jem!  
Rrudhat ujore buzëqeshin  
Mbi ujin e gjetur  
Përse e kam parë në ëndërra  
Jetën time, të vetmen?*

*\*\*\**

*Jam bariu i grigjave  
Grigjat janë mendimet e mia  
Dhe mendimet e mia janë të gjitha të jashtëzakonshme.  
Se unë mendoj  
Edhe me sy edhe me veshë,  
Mendoj edhe me gojë edhe me hundë.  
Të mendosh një lule  
Është ta shohësh e t'ia ndijosh aromën,  
Të hash një frut  
Do të thotë t'i mësosh përmbajtjen.*

*Ndaj kur në ditën e ngrohtë  
Ndjej dridhmën të shijoj sa më shumë  
Shtrihem në bar symbyllur  
E ndjej gjithë trupin tim të zhytur në realitet  
Veç kështu e di të vërtetën  
E jam... i lumtur.*

*\*\*\**

*Si një brumbull zjarri në terr  
Dielli vonohet  
Të hyjë në mjegullat  
Që do të mbeten ende.  
Një klithmë përhapet në mbrëmjen pa cak  
E një treni të largët  
Një mall endet mbi mua  
E një epsh i heshtur endacak  
Shkon dhe ikën.  
Shpesh mbi sipërfaqet e ujërave  
Formohen bulëza,  
Që shfaqen dhe zhduken  
E s'kanë kuptim tjetër  
Përveç të qenit bulëza...*

*\*\*\**

*Nëse do të mundja ta kafshoja tërë tokën  
Do t'ia ndjeja shijen,  
Do të isha për një çast më i lumtur,  
Por jo gjithmonë dua të jem i lumtur.  
Nganjëherë është më e nevojshme  
Të jesh i hidhëruar  
Për të qenë më i natyrshëm.  
Jo të gjitha ditët janë me Diell  
Ndaj i përmendim dhe shirat  
Ndaj palumturia dhe lumturia  
Lehtësojnë, për njeriun, që s'habitët  
Se ekzistojnë male dhe dete*

*Gurë dhe lule.  
E rëndësishme është  
Të jesh i natyrshëm dhe i qetë  
Në lumturi dhe në fatkeqësi.  
të ndjesh si ai që sheh  
Të mendosh si ai që udhëton  
E në çastin e vdekjes  
Të kujtohesh se dhe dita vdes  
Se perëndimi që i bukur  
Po e bukur dhe nata që mbetet  
Kështu është,  
Kështu do të jetë!*

*\* \* \**

### **ODE NATËS**

*\* \* \**

*Eja o Natë antike dhe që je vetvetja,  
Natë e Mbretëreshë e shfronësuar sapo lind,  
E barabartë përbrenda me qetësinë,  
Natë me yjet – stoli të rreme,  
Që lëvizin mbi petkun tënd  
Plot thekë pafundësie!  
Eja e mjegullt,  
Eja butësisht,  
Eja e vetme,  
Eja solemne,  
Me duart e nderura  
E m'i sill tërë malet e largët  
Ashtu si dhe pemët e afërta!  
Shkrijë në një fushë tënden  
Tërë fushat që shoh,  
Bëji vargmalet njësh  
Me trupin tënd!  
Shuaji tërë dallimet, kontrastet,  
Të gjitha rrugët*

*Të gjitha pemët e ndryshme  
Me klorofilin e errët në largësi!  
Mpiksi të tërë shtëpitë e bardha  
Që tymosin mes pyllit,  
Lër të lutem veç një dritë,  
Po edhe një tjetër, edhe një të tretë  
Në distancat e paracaktuara  
Dhe vagëllimthi shqetësuese  
Në distancat e pamundura  
Për t'i përshkruar o Zonja Jonë  
Në gjërat e pamundura,  
Që më kot i kërkojmë,  
të ëndrrave,  
Që vijnë e na vizitojnë në mugëtirë,  
Buzë dritareve dhe qëllimeve,  
Mbi tarracat e hoteleve kozmopolite,  
Mbi det, mes tingujve  
Të muzikave europiane  
Dhe zërave të largët dhe të afërt!  
Eja o Natë e na përkund,  
Eja e na ngushëllo,  
Na puth mbi ballë,  
Aqsa të mos e kuptojmë  
Puthjen tënde të lehtë  
E të ndjejmë ndryshimin në shpirt,  
Si dhe një dënesë,  
Që vjen mistershëm  
Nga hershmëria,  
Ku i kanë rrënjët  
Këto pemë mrekullish,  
Frutat e të cilave  
Janë ëndërrat,  
Që dashurojmë me ankth!  
Se ende i dimë pa lidhje*

*Këto ëndërra  
Me atë ç'ka mund të na ndodhë në jetë!  
Eja pafundësisht solemne,  
Me dëshirën e fshehtë  
Për të qarë të prekur thellë,  
Sepse i madh është shpirti,  
Po sa e vogël bota,  
Se jo të gjitha gjestet  
Di t'i bëj trupi jonë,  
Arrijmë deri aty,  
Ku veç arrin krahu ynë  
E shohim aqsa na shohin sytë!  
Eja kaq e dhimbshme  
O Mater Dolorosa<sup>1</sup> e të ndruajturve,  
O Turris Eburnea<sup>2</sup> e të përçmuarve,  
Je e vetmja dorë e freskët  
Mbi ballin plot ethe të të përulurve,  
E vetmja shije uji burimi  
Mbi buzët e thara të të lodhurve!  
Eja që nga thellësitë e horizontit  
Eja e më rrëmbe mua  
Nga plogështia ku marr frymë  
Nga trualli i shqetësimeve  
I jetës plot tepri  
Të ndjesive të rreme  
Mes të cilave  
I natyrshëm kam mbirë!  
Më mblidh me dorën tënde  
Mua si lulen margarita  
Të harruar e të lënë pas dore,  
Mbuluar nga hija e barërave,  
Petale më petale  
Lexo tek unë  
Nuk di cilin fat,*

*Që gjethet i këput  
Për hirin tënd o Natë,  
A për kënaqësinë  
E heshtur dhe të freskët!  
Një petalin time  
Hidhe drejt Veriut  
Ku lindën qytetet e sotme  
Zhurmën e të cilave  
E dashurova si të ishte një trup i vetëm!  
Një petale tjetër  
Vërtite drejt Jugut  
Ku janë detet  
Dhe aventurat e ëndërruara!  
Një tjetër petal  
Jepja Perëndimit,  
Ku digjet inkandeshente  
Gjithçka që është e Ardhmja,  
Ku egërsohen shpirtrat  
E morali nuk arrin!  
Petalin e katërt, e gjithë të tjerat,  
Plot tingëllima të fshehta  
Këmbanash kushtrimi shpirtëror  
Besoja Lindjes,  
Lindjes prej nga vjen gjithçka,  
Dita dhe fetë,  
Lindjes pompoze,  
Fanatike e të nxehtë,  
Lindjes së tepruar,  
Që unë s'do të shoh asnjëherë,  
Lindjes budiste,  
Shintoiste  
E lakmitare!  
Lindjes që është gjithçka  
Që ne nuk e kemi,*

*Lindjes, që kush e di pse,  
Veç aty ende jeton sot vetë Krishti,  
Ku ende Zoti  
Jeton trupërisht –  
Perandor i gjithçkaje universale!  
Eja mbi detrat,  
Mbi ujërat e mëdha  
Mbi oqeanin me horizonte të pacaktuara,  
Eja e kalo dorën  
Mbi shpinën e tij prej bishe  
E qetësoje si me magji  
O Zbutëse e Madhe  
Plot hipnozë  
Mbi gjithçka gumëzhuese!  
Eja, e kujdesshme  
Majës gishtave  
O Natë, Infermiere e Lashtësive të Herëshme  
Që u rri mbi kokë vetë zotave të plagosur  
Të feve, tashmë të humbura  
O Natë që pe  
Si të lindëte Jupiteri e Jahovaj,  
Ishe ti që u buzëqeshe skeptike  
Se për ty gjithçka është e rreme  
Përveç territ dhe të heshtjes  
Si dhe Hapësira e Mistershme mes tyre!  
Eja o Natë e heshtur dhe e dehur,  
Zemrën ma mbështill  
Me mantelin tënd të butë  
Me një gjest mëmësor  
Që fal veç siguri!  
Eja me yjet e ndritur  
Që janë Maska e së Përtejmes  
Plot pluhur ari i ke flokët  
Dhe Hëna bjen*

*Prej fytyrës tënde!  
Çdo tingull dëgjohet ndryshe  
Kur ti më në fund mbrin  
E zërat shuhen!  
Askush nuk të dallon kur hyn,  
Askujt s'i bije në sy kur vjen  
Gjersa befas ndjejnë  
Gjithçka që mblidhet  
E humbin kornizat dhe ngjyrat  
Me qiellin e bardhë në horizont  
Kur Hëna lind  
E nis atë që është drita e saj!  
1) Nëna Dhimbje (lat.)  
2) Varri i Fildishtë (lat.)  
\* \* \**

## **HUMNERA**

*\* \* \*  
Mes ndërgegjes time dhe meje  
Është një humnerë,  
Ka një fund të padukshëm,  
Ku rrjedh një lumë zhurmues,  
Larg edhe nga vetë të vetmuarit.  
O zhurma është e ftohtë, po e vërtetë,  
Aty çdo pikë e mendimit tim  
Është gjithashtu e ftohtë, por dhe e errët,  
Pabesueshmërisht e lashtë në vetvete,  
Por jo në dukjen e paraqitur!  
Të dëgjuarit e mi është të shikuarit e mi,  
Është pikërisht ky lumë gati pa hapësirë,  
Zhurma e tij që çliron gjithmonë  
Mendimin tim  
Nga pushteti i ndjesisë për të ëndërruar.  
Veç një realitet i frikshëm  
I përket këtij lumi këngësh pa zë,*



*Një realitet abstrakt,  
Që flet për mosrealitetin,  
Për lëvizjen e lumit  
Drejt kurrfarë deti!  
Dhe ja në sytë e të ndjerit tim të ëndërruar  
Ndjej të paparin lumë  
Drejt vendit, ku në fakt nuk shkon,  
Pra, drejt tërë gjërave përbërëse të mendimit tim  
Të vetvetes, të botës dhe të Zotit  
Që janë dallgët e këtij lumi të pamundur.  
Ah, idetë e botës dhe të Zotit  
Të vetvetes time dhe të misterit  
Si prej një katarakti të epërm rrjedhin  
Tek ky lumë, përherë drejt detit,  
Që s'arrihet kurrë,  
Po që i përket lëvizjes të ngjizur me natën  
Gjithmonë drejt Diellit të plazhit  
Të një oqeani të pakapshëm!*

*\* \* \**

### **AUTOPSIKOGRAFI**

*\* \* \**

*Poeti është mjeshtri i shtirjes,  
Shtiret kaq mrekullisht  
Sa arrin të jetë dhimbje  
Në thelbin e shpirtit.  
E kur lexojmë ç'ka shkruar  
Këtë dhimbje e ndejmë tonën,  
Jo atë që poeti e ka vuajtur,  
Por thjeshtë pjesën që na mungonte!  
Dhe kështu në shinat e një sferë  
Rrotullohet, duke gënjyer arsyen,  
Ky tren që është poeti  
I quajtur edhe zemër!*

*\*\*\**

*E kërkuan engjëjt  
Dhe e gjetën pranë meje,  
Ku e kishin sjellë flatrat e saj!  
Ta merrnin donin engjëjt,  
Se ajo qe larguar  
Prej shtëpisë së tyre  
Në një ditë pafundësisht të qartë  
Për të banuar tek unë!  
Më dashuroi se dashuria  
Dashuron veç gjërat e papërkryera,  
Po engjëjt nga sipër  
Erdhën dhe ma rrëmbyen,  
Ma morën përgjithmonë  
Mes flatrave të tyre shkëlqimpërhapëse.  
Është e vërtetë se ajo  
Qe motra e tyre,  
Qe po aq afër Zotit  
Sa edhe ata!  
Po ajo më dashuroi mua,  
Se zemra ime s'kishte një motër.  
E morën me vehte,  
Kjo ishte gjithçka që ndodhi!*

*\* \* \**

## **LIKANTROPIA**

*\* \* \**

*Nëse diku ëndërrat bëhen realitet  
Është pikërisht liqeni vetmitar  
Për mua dhe për ty përfundimisht  
Dhe asnjë vend tjetër nën Hënë!  
Këtu vela e bardhë hapet  
Nga një erë e vagullt dhe e panjohur,  
Lëviz jetët tona ëndërra,  
Ku ujërat shkrijnë kufijtë!  
Tek një bregdet pemësh të zeza*

*Ku pyjet misterioze i japin  
Liqenit dëshirën që të jetë më shumë,  
Që kështu ëndërra të jetë e plotë!  
Këtu do të fshihemi e do të zhdukemi  
Nën mjegullat e lehta hënore,  
Duke kuptuar se jemi mbrujtur  
Edhe nga një esencë muzikore.*

*\* \* \**

### **ËNDËRRA**

*\* \* \**

*Është një vend i vetmuar  
Lagunë me heshtje dhe Hënë  
Pa asnjë klithmë  
Veç rrëzimit të erës  
Sikur i bije të fikët.  
Ç'kalim i ndërgjegjshëm  
Mes ëndrrës dhe tokës.  
U qetësua era  
Në ujërat plot alga,  
Ku zhysnim duart tona.  
I linin duart të lëkundeshin  
Në ujërat e pazakonta,  
Sytë na ndritnin  
Prej spërdredhjes së Hënës  
Në skenarin e pyllit.  
Kështu humbisnim shpirtin  
E të qenit vetvetja  
E ishim të lirë si nimfat,  
Duke mos patur asgjë  
Të trashëgonim prej qenies.  
Po nimfat dhe djallushët  
Vishnin me purpur  
Lëvizjet e tyre të ndritshme  
Dhe kështu ne nën Hënë*

*Arrijmë të pushtojmë  
Unin e pakapshëm,  
Që s'fitohet plotësisht asnjëherë!*

*\* \* \**

## **NDJESI**

*\* \* \**

*Shpirti im i trembet mendimeve  
Dhe më rrëngjeth harresa!  
Nganjëherë pushtohem  
Nga një frymë e ftohtë dhe e trishtë  
E paqetësueshme dot,  
Që lakmon të jetë shpirtërore!  
E bëhem i njëjtë me barin,  
Ngjyroset jeta ime nga gjithë lulet  
Flladi shkund  
Prej orëve të mia shumë petale  
Dhe zemra më përvëlohet  
Me gjithçkanë pa shira!  
Vetë Zoti metamorfizohet  
Në vesin tim, por ndjenjat hyjnore  
M'i mbytin shqisat  
E nuk më lënë të kem  
Perceptime sipas mënyrës time,  
Për ta parë vetë Zotin  
Si rritet, duke shkëlqyer!  
Ngatërrohen ndjenjat dhe mendimet  
Në një unitet shpirti të vagullt  
Si deti që parandjen shtrëngatën!  
Dhimbja e plogët dhe shqetësimi  
Më kthejnë të tërin  
Në një murmurimë të një tufe kërcënuese.  
Shterin mendimet, ose përzihen  
Në bashkëpërfshirje, uzurpojnë  
Vendin e njëri-tjetrit.*

*S'ka gjë brenda meje  
Përveçse të pamundurës –  
Amalgamë e shumë gjërave  
Siç jam!  
Ndaj pi e dehem me mendimet e mia,  
Thelbi i ndjenjave  
Ma përmbyt shpirtin,  
Po vullneti im mbarset aty!  
Pastaj jeta në kalim e ndal një ëndërr  
Dhe e bën të lulëzojë  
E kjo është bukuria  
Në gjoksin e dhimbjes së vargjeve të mia!*



\* \* \*

### **VIOLINISTI I ÇMENDUR**

\* \* \*

*As nga udha e Veriut  
As nga e Jugut s'erdhi  
Muzika e tij e egër*

*Për herë të parë në fshat.  
Violinisti u duk në shteg,  
Të gjithë dolën ta dëgjonin  
Ai iku. Me dëshpërim, më kot,  
Shpresuan të rishihnin.  
Po muzika e tij e jashtëzakonshme  
Qe veç ndjesi lirie.  
S'ishte thjesht melodi,  
As e kundërta e saj!  
Në këtë vis të largët,  
Në këtë truall antik  
Banorët e shtrënguar  
Të jetonin aty, u tronditën.  
Dhe reaguan ndaj tingujve  
Sipas një domethënie të harruar,  
Që gjithkush e kish  
Në një kërkim të vdekur.  
Sakaq nusja e lumtur kuptoi  
Se kish bërë martesën e gabuar,  
Të dashuruarit e ethshëm  
S'dashuruan dot më.  
Ndoshta nusja dhe dhëndri qenë të lumtur  
Thjesht se e kishin ëndërruar këtë,  
Po veç zemrat e trishta vetmitare  
Befas u ndjenë më pak të vetmuara.  
Në çdo shpirt shpërtheu një lule,  
Që po të prekje linte pluhur pa dhe.  
Çdo shpirt binjak  
Plotësonte ç'ka i mungonte.  
Dhe vjen një hije që bekon  
Nga thellësitë e pashprehura,  
Një shqetësim drite  
Më i mirë se sa ndalja në vend.  
Se violinisti i çmendur*

*Ashtu siç erdhi edhe iku  
Tamam si një gjysmë qenie  
Plotësuar nga heshtja dhe kujtesa.  
Ah, të qeshurat i braktisën ata,  
Vdiq çdo shpresë e fandaksur  
E pastaj harruan  
Se violinisti i çmendur kishte qenë.  
Megjithatë, kur ankthi i të jetuarit –  
Se jeta s'është siç e do  
Rikthehet në orët e ëndrrave  
Të prekë ftohtësinë e ndjenjave,  
Befas secili kujton  
Nën shkëlqimin e Hënës së re  
Mes hirit prej jete dhe ëndrre  
Melodinë e violinistit të çmendur!*

\* \* \*

### **POEZI TË ALVARO DE CAMPOS**

\* \* \*

#### **ODE DETARE**

*I vetëm, mbi portin e heshtur, këtë mëngjes  
Shikoj drejt të Papërcaktueshmes  
E kjo gjë më jep ndjesi gëzimi.  
Kur dalloj se si një skaf afrohet nga e panjohura.  
Një skaf i vogël, klasik në mënyrën e vet  
Sëbashku me mëngjesin vjen në port  
Le pas vetes gjithçka  
Mes varkave dhe anijeve të tjerë  
Gjallëron hapësirën  
Shpirti im gjendet e lëviz  
Tek ky skaf,  
Që është referencë e distancës dhe mëngjesit  
Dhe e sensit detar  
Një dhimbje e ëmbël  
Ngjitet brenda meje*

*Sikur të zë deti  
Jo thjesht në trup,  
Por dhe në shpirt!  
E shikoj këtë skaf me një liri të madhe ndjesimi,  
Diçka fluturuese rrotullohet tek unë  
Se ky skaf sjell në sytë e mi  
Misterin e gëzueshëm  
Të gjithçkaje që vjen dhe niset  
Duke sjellë kujtesat  
E tërë porteve të vetmuar  
Që janë një tjetër mënyrë të qeni  
E të njëjtit njerëzim në të tëra pikat  
Se çdo akustim i anijeve  
Dhe çdo nisje e tyre në lundrim  
E ndjej se është  
Në pavetëdije një simbolikë  
Me nënkuptime metafizike  
Që më turbullon  
Për një kohë  
Kur kam qenë më parë.  
Ah çdo port është nostalgji gurësh!  
Kur niset anija  
Kuptojmë se është hapur hapësira  
Mes portit dhe anijes  
E na kap një ankth,  
Një mjegull trishtimi  
Shndrit Diellin e shqetësimeve  
Krejt si një dritare  
Që pasqyron agimin  
E që ngjan si një kujtim  
I një tjetër personi,  
Që ishte fshehtas  
Edhe vetja ime!  
Ah kushedi*



*S'do të jetë më ajo kohë  
Që përpara meje qe nisur  
Nga një port, që s'e ka lënë  
Trupin e anijes  
Në diagonalen e mëngjesit  
Drejt një porti tjetër.  
Kushedi, kushedi  
S'e ka lënë anijen  
Përpara oqeanit të botës së jashtme  
E tani ajo shkëlqen  
Mbi mua që jam port i saj gjysmë i shkretë  
Port i një qyteti gjysmë të gjetur,  
Qytet i madh tregtar  
I zhvilluar dhe paralitik  
Dhe i mundur për të qenë  
Jashtë hapësirës dhe Kohës.  
Detare është jeta!  
Gjithçka është jetë detare!  
E përvëlton gjakun tim  
Kjo këndellje e madhe  
E unë fantazoj pandërprerë  
Veç udhëtime të pafundme!  
Ah brigjet e largëta  
Të rrafshuara nga horizonti  
Ah kapitenet e anijeve, ishujt, plazhet e rërës,  
Vetmitë detare si momente të veçantë në Paqësor,  
Për të cilin kam magjepsje  
Për faktin se është më i madhi i oqeanëve  
Dhe kështu bota dhe shija e gjërave  
Bëhet një shkretim brenda meje!  
O, përmasat më njerëzore e disangjyrëshe të Atlantikut,  
Oqeani Indian, më i mistershmi,  
Mesdheu i butë, klasik e pa mistere,  
Bërë posaçërisht për përplasjen e dallgëve*

*Përballë tempujve me statuja antike!  
O të gjitha detet,  
Të gjitha ngushticat, të gjitha gjiret,  
Dua t'i shtrëngo  
Në gjoksin tim  
T'i ndjej në thelb  
E pastaj të vdes!  
Në hapësirat e paane  
Ku ujërat më thërrasin  
Tërë zërat e njerëzve  
Janë një zë i vetëm trupor  
Tërë epokat detare  
Të ndjera në të shkuarën,  
Mua më thërrasin!  
Do të doja të isha kafsha,  
Që përçon tërë gjestet e njerëzve,  
Një kafshë që kafshon  
Që ha pemët,  
Që pi gjak e kuvertat e drunjta,  
Që përtyp velat, lopatat, timonët,  
Pra një dragua deti,  
I përbindshëm,  
Që ushqehet me krime!  
Ç'simfoni sensacionesh hermetike e të ngjashme  
Ç'orkestrim i gjakut tim  
I turmave kriminale  
I zhurmave torturuese të orgjive,  
I rrymave të nxehtë të shpirtit!  
Ç'mjegullim i pluhurit djegës  
Që turbullon qartësinë time  
E të gjitha këto m'i bën  
T'i ëndërroj brenda lëkurës!  
Anija me imagjinimin e një spirance  
Gjysmë të zhytur*

*E me ankthin – lopatë e copëtuar  
Dhe trupi i nervave të mia të lagure  
Që thahet në një plazh, plot Diell!  
Çdo avullim i largët  
Është një anije me vela nga afër  
Çdo anije e largët tani  
Është edhe ajo që qe në të shkuarën  
Tërë detarët e padukshëm të anijeve  
Janë detarët e dukshëm  
Të kohës së anijeve të vjetra  
Të epokës së ngadaltë të veliereve  
Të lundrimeve të rrezikshme  
Të epokës së drurit dhe pëlhurës  
Të udhëtimeve në muzgjet e erërave.  
E mua më mbërthen deliri i gjërave detare  
Më hyjnor më bën trupin  
Porti dhe atmosfera e tij  
E thellohem në ëndërrat e njerëzve.  
Rripat e transmetimit të mekanizmave  
Metonikë të anijes e vënë në lëvizje  
Shpirtin tim  
Për rritjen e shpejtësisë  
Ju mjete lundrimi - lodrat e mia të vjetra të ëndërrimit  
Bëjeni jashtë meje  
Jetën time të brendëshme!  
Skafi, velat, rrobat e timonit, litarët,  
Elikat, flamujt, kavot, kaldajat, valrnat,  
Derdhini brenda meje si një tërësi jetike  
A si një përmbajtje konfuzë  
E një arke të boshatisur përdhe!  
Jeni ju thesari im,  
Jeni dhe enigma e overisë sime të ardhshme,  
Jeni ju frytet e pemës time të imagjinatës,  
Tema e këngëve të mia,*

*Jeni gjaku në venat e intelektit tim  
Jeni çarku që më kap së jashtmi  
Si një instrument i estetikës!  
Sillmëni metafora  
Sillmëni imazhe, literatura,  
Sepse Vërtetësisht,  
Seriozisht,  
Letërsisht  
Ndjenjat e mia  
Janë anija me portet në ajër  
Piratet, anijet,  
Ora detare ku mbërthehen viktimat  
Tmerri i të kapurve, robërve  
I kthyer në çmenduri  
Ora detare është sinteza e krimeve, terrorit,  
Anijeve, deteve, qiellit, erërave  
Gjerësive e gjatësive gjeografike  
E të gjithë këto janë një ulërimë  
Një totalitet i trupit tim  
Totalitet i vuajtjes  
I tërë qenies time të plagosur  
Me mishin irreal të shpuar të shpirtit.  
Jam i tëri në të gjitha krimet!  
I tëri në gjithësinë e elementeve  
Që përmbajnë sulmet ndaj anijeve,  
Në masakrat dhe përdhunimet  
Në çdo gjë që ndodh në vendin e plaçkitjeve  
Në atë që u bë më pas  
Në tragjeditë e gjakut!  
Jam i tëri pirati që rimerr tërë piraterinë, që në krijimin e saj  
Sinteza prej mishi e kocke  
I tërë piratëve të botës.  
Dikur në të vjetrën e të qetën shtëpi buzë lumit  
Dritaret e dhomës sime, e asaj të ngrënies*

*Shihnin përtej ca shtëpive  
Mbi lumin që është pranë mbi Togo.  
Dhe tani Togo është i njëjti,  
Por në një tjetër pikë.  
Nëse do më duhej të shfaqesha në të njëjtat dritare  
Do të ishte njësoj si të mos shfaqesha në të njëjtat dritare.  
Se koha e dikurshme  
Është shpërndarë si tymi i një anije  
Të zhdukur mes ujërave!  
Një butësi e pashpjegueshme  
Një brerje mallëngjimi gjer në dënesë  
Për të gjitha viktimat  
Që kur ishe fëmijë  
E kam provuar  
Kur imagjinoja vehten si një pirat të vjetër.  
Dridhesha nga emocionet  
Sepse i ëndërroja si viktimat e mia  
Por asgjë s'ka ndodhur realisht  
Qe veç një përkëdhelje e ngatërruar  
Si një qelq i verbër,  
Gjersa kthjelltësia  
Thurte këngët e vjetra të shpirtit tim të dhembshur  
Ah, si vallë kam mundur  
T'i mendoj e t'i fantazoj këto gjëra?  
Sa larg jam tani  
Nga vetja që isha dikur!  
Ç'histeri sensacionesh  
Dhe tani veç një gjendje pos të kundërtave  
Në mëngjesin biond që po ngrihet  
Ndiçimi im zgjedh vetëm imazhe,  
Që akordojnë me këto përplasje  
Emocionesh dhe ujërash  
A të valëzave të butë  
Të ujërave buzë portit.*

*Ja valët që kalojnë njëra pas tjetrës  
Malet si largësi, një e kaltër japoneze,  
Shtëpitë e Almadës  
Që ruajnë ende  
Ëmbëlsinë e foshnjërinë e mëngjeseve.  
Një pulëbardhë kalon  
Dhe dashuria ime shumëfishohet.  
Gjatë gjithë kësaj kohe  
S'jam përkujdesur për asgjë  
S'kam bërë asgjë  
Për gjatë gjithë kësaj kohe  
S'i largova sytë nga ëndërra e largët  
Nga shtëpia ime pranë lumit  
Nga fëmijëria ime pranë lumit  
Nga dritaret e dhomës time mbi lumë.  
Sa e mrekullueshme jeta detare moderne!  
Gjithçka e pastruar, me makineri dhe shëndet  
Gjithçka e pajisur shkëlqyeshëm  
Dhe kaq shpërfillshëm organizuar  
Tërë pjesët e makinerive  
Dhe vetë anijet që s'numërohen dot  
Në botën e tregëtisë, të eksportit e të importit  
Të habit ky kombinim i mrekullueshëm  
Ku gjithçka rrjedh  
Prej vetë ligjit të natyrës  
Ku asnjë element  
S'është pengesë për tjetrin!  
Ja dhe shpjegimi pse s'ka humbur poezia!  
Për më tepër edhe sot shumë vetë  
Kanë makina për poezitë e tyre  
Që janë një lloj i ri i jetës komerciale  
Qoftë dhe mondane, sentimentale  
Që epoka e makinave ka sjellë mbi shpirtrat!  
Të udhëtosh tani është po aq bukur sa dikur*

*Dhe një anije është e bukur  
Qoftë edhe vetëm se është thjesht një anije.  
Udhëtimi është akoma udhëtim  
Dhe largësitë janë po ato,  
Po aq tunduese, falë Zotit!  
Këtë çast dua të jem  
Në trupin e anijes që po del nga porti,  
Është një Tremn steamer anglez,  
Anije shumë e pistë,  
E ngjashme me anijet franceze  
Me një aromë shpuese  
Të një proletari detesh.  
E nisja e sotme që lajmëruar  
Që dje në faqet e fundit të gazetave.  
Shpirti im zbutet  
Duke parë sërish skafin e thjeshtë e natyral  
Ngjan të ketë një tjetërloj ëndrre  
Ngjan si të ishte një person i ndjeshëm  
Që i bindet  
Çfarëdolloj detyrimesh.  
Anija angleze ikën,  
Por dhe ky skaf do të ikë,  
Për ku?  
Për Kardif? Për Liverpul?  
Për Londër?  
Nuk ka fare rëndësi!  
Bën detyrën e tij, siç bëjmë ne tonën  
Ç'jetë e kuptimshme!  
Udhë e mbarë!  
Udhë e mbarë!  
Udhëtim të mbarë o miku im i rastit,  
Që më bëre nderin  
Të lëngoju ndërmjet trupit tënd,  
Ethet dhe trishtimet e ëndrrave të mia!*

*Duke më kthyer në jetë  
Për të të vështruar ty  
Si shkon e ku po shkon  
Udhë e mbarë!  
Kjo është jeta!*

*\*\*\**

*Dritaret e dhomës time,  
E dhomës së njërit nga miliona njerëz që s'e njeh askush  
(E nëse do ta dinin se kush është  
Ç'rëndësi do të kishte kjo?)  
Shohin fshehtësinë e një rruge  
Vazhdimisht të përshkruar nga kalimtarë,  
Shohin gjithashtu edhe rrugën ende të pahapur  
Për mendimet e mia reale, të qarta,  
Panjohshmërisht të prekshme,  
Shohin misterin poshtë gurëve dhe qenieve  
Dhe vdekjen që përhap lagështirë  
Në poret e lëkurës dhe flokët e thinjura  
Drejt Fatit, drejtues i Karros të gjithçkaje  
Nëpër infinitin e hiçit.  
Sot mund të njoh të vërtetën,  
I kthjellët si të isha në pikën e vdekjes  
Në një vëllazëri me gjërat  
Që më japin lejë për t'u nisur  
Kjo shtëpia ime dhe çdo anë e rrugës  
Të bëhen vagonët e një treni  
Që nisja plot fishkëllima  
Nga brendia ime e kokës  
Të m'i dridhte nervat  
Duke m'i rrëzuar eshtrat  
Pikërisht që në fillim të lëvizjes!  
E jam i hutuar si ai që ka menduar, ka gjetur dhe ka harruar  
pastaj  
Jam i ndarë në dysh*



*Midis ndershmërisë që i detyrohem  
Dhe këtij dyqani përballë  
Si një gjë reale nga përjashtësia  
Dhe ndjesisë që gjithçka është ëndërr  
Si një gjë reale nga përbrendësa!  
Kanë bërë me mua  
Atë gjë që unë s'e kam ditur  
Dhe unë atë që mund të bëja s'e bëra.  
Qëllimi që i gabuar,  
E më kanë njohur në vijimshëri  
Me atë që s'isha  
Por s'e kam përgënjeshtuar këtë  
Dhe jam ndjerë i humbur.  
Kur desha ta heq maskën  
Më që ngjitur me fytyrën  
Por kur e hoqa dhe u pashë në pasqyrë  
Isha përfundimisht i plakur.  
Isha i dehur, se dija qëllimin  
Që ndoshta e kisha refuzuar.  
E kam hedhur maskën,  
Kam fjetur në gardërobë  
Si qeni e rrugëve i toleruar  
Nga administrata e qytetit.  
E pra edhe i pambrojtur  
Dua ta shkruaj një histori  
Për të provuar se jam krejt sublim,  
Esencë muzikore e vargjeve të mi të kotë  
Që i takoj shpesh  
Si diçka të bërë jo nga unë  
Sikur s'kisha qëndruar përherë  
Përballë këtij dyqani  
Duke shkëlmuar ndërgjegjen e ekzistencës  
Si tapetin ku i dehuri rrëzohet,  
Si tendën e vjedhur nga ciganët*

*Që nuk vlen kushediçfarë.  
Pronari i dyqanit  
Është shfaqur në portë  
Dhe aty mbeti  
E shoh as me përparësinë  
Që më jep koka ime gjysmë e përkulur,  
As me ngurimin e shpirtit,  
Që po hamendëson.  
Pronari do të vdesë,  
Po edhe unë do të vdes.  
Ai do të lerë testamentin,  
Unë do të le vargjet  
Pastaj do të vdesë edhe rruga  
Zyra ku u bë testamenti  
Do të vdesë dhe gjuha  
Me të cilën u shkruan vargjet.  
Më në fund do të vdesë dhe planeti  
Që rrotullon gjithçka që ndodh brenda tij,  
Në sisteme planetësh të tjerë  
Ndoshta do të vazhdojë diçka  
Siç ndodh edhe me njerëzit  
Për atë që mbetet nga testamenti,  
Apo nga vargjet.  
E thashë do të vdesë edhe planeti  
E gjërat do të mbeten përballë njëra-tjetrës  
Gjithmonë një gjë e kotë sa dhe tjetra,  
Gjithmonë e pamundshmja kaq e mefshtë sa edhe realja,  
Gjithmonë thellësia e qartë si gjumi i misterit të sipërfaqes,  
Gjithmonë një gjë që s'është vetvetja as tjetër gjë.  
Në shtëpinë përballë meje e ëndrrave të mia  
Banojnë njerëz që s'i njoh  
Që i kam parë edhe pa i vështruar  
Janë ndoshta të lumtur  
Sepse "ata" nuk janë "unë".*

\*\*\*


*Fëmijët që luajnë në tarracat e shtëpisë  
Jetojnë mes vazo lulesh  
Gati në përjetësi.  
Zërat që ngrihen nga intimiteti i shtëpisë  
Këndojnë gjithmonë,  
Sepse duhet të këndojnë padyshim.  
Jashtë s'ka festë,  
Po atje brenda ka festë  
Kështu ndodh atje  
Ku gjithçka përshtatet  
Si njeriu ndaj natyrës,  
Se edhe qyteti është natyra.  
Ç'lumturi e madhe e tyre  
E të mosqenit të tyre si unë!  
Po a ka të tjerë,  
Që do të ndihen si unë?  
Cilët të tjerë? Nuk ka të tjerë!  
Ajo që ndjejnë të tjerët  
Është shtëpia që mbyll e hap dritaret  
Që fëmijët të mund të luajnë  
Në verandën me harqe  
Mes vazove të luleve  
Që kurrë s'i pashë se si ishin!  
Të tjerët nuk ndjejnë kurrë!  
Kush ndjen jemi "ne"  
Po, po të gjithë "ne"  
Madje edhe "unë"  
Që tani s'ndjej asgjë.  
Asnjë!  
Por një asgjë që dhëmb!*

\*\*\*

*Kujtoj fare mirë shikimin e një njeriu,  
Ma përshkoi tërë shpirtin*

*Si zjarr rrëshqanor nëpër natë  
Kujtoj shikimin e tij. Ç'ka mbeti?  
Ajo që mbeti qe vetëm një dukje e jetës.  
Dje kam shëtitur rrugëve si çfarëdolloj njeriu,  
Kam parë me shpërfillje vitrinat,  
S'kam takuar asnjë mik,  
Që mund të flisja  
Papritur u ndjeva i trishtuar për vdekje,  
Aqsa m'u duk  
Se s'mund të jetoja asnjë ditë më tepër,  
Dhe kjo jo se mund të vrisja veten  
Por se s'doja të jetoja më  
Ditën e mëpasme!  
Tani tymos cingare,  
Ëndërroj në kolltuk  
Më dhemb të jetoj në këtë situatë disavantazhi.  
Duhet të jenë diku ishujt  
Drejt një Jugu të gjërave  
Ku që të vuash është diçka e ëmbël,  
Ku të jetosh është më pak se sa mendimi,  
Por që është e mundur symbyllur të dremitësh nën Diell  
E të zgjohesh pa u shqetësuar  
Për përgjegjësitë shoqërore  
As në ditën e javës a të muajit,  
Ditës që është sot.  
Brenda meje kam mbyllur  
Zemrën time çuditërisht spontane  
Si një armik që ndruhem ta lëndo.  
Zemrën që ndjen atë që ëndërron si të ishte reale  
Zemrën që shoqëron duke ecur  
Tërë melodinë e këngëve  
Që mendimi im i këndoi  
Në rrugët e ngushta  
Që qullen nën shirat!*

\* \* \*



*Lisbonë, qershor 1998: Moikom Zeqo, në manastirin e shën Hieronimit, pranë shtyllës katërkëndëshe memoriale për Fernando Pessoa - të ngritur në vitin 1985.*

~~~~~  
© Pashtriku.org, Mars 2014
~~~~~